

FJALA E DEPUTETES LINDITA METALIAJ

E ENJTE 31 MARS 2022

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë që po na ndiqni,

Sot është paraqitur për miratim akti normativ nr. 3 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin “Për buxhetin e vitit 2022”. Në fakt, na paraqitet si një hap i rëndësishëm dhe shpëtimtar për shqiptarët. Në të vërtetë nuk është i tillë. Kjo lloj shtese dhe ky lloj ndryshimi nuk prek asgjë në mënyrë rrënjësore; nuk prek asgjë në mënyrën e duhur, në mënyrën që do ishte e përshtatshme dhe efektive. Kjo duket më shumë si një lëvizje mashtruese, si një lëvizje e detyruar nga reagimet dhe pakënaqësia popullore, jo si një strategji apo politikë qeveritare kundër varfërisë, kundër pasojave të krizës.

Prandaj, këto shtesa e ndryshime mund të quhen meremetime, bishta, ose arnime, por asgjë më shumë se kaq. Nuk mund ta zgjidhim situatën, pa shkuar te problemi i vërtetë. Cili është problemi i vërtetë? Cili është shkaku i varfërisë në vend? Pa dyshim, është modeli ekonomik. Nëse nuk ka një model ekonomik që gjeneron të ardhura dhe qarkullon para, atëherë arnimi nuk e zgjidh varfërinë, meremetimi nuk e zgjidh krizën sociale, justifikimi nuk e zgjidh braktisjen e Shqipërisë. Modeli ekonomik që kemi, është modeli ekonomik i monopoleve dhe i oligopoleve. Është modeli i shtetit të centralizuar së tepërmi. Ajo që quhet rritje ekonomike, shkon vetëm për 10-15 njerëz dhe populli nuk përfiton nga rritja ekonomike imagjinare, përkundrazi ka mbetur në vendnumëro. Prandaj këtë problem nuk e zgjidh lëmosha. Një lëmoshë sot, një lëmoshe nesër, po pasnesër çfarë do të bëjmë? Vazhdon e njëjta gjendje, vazhdon e njëjta agoni dhe i njëjti dëshpërim social.

Le të marrim dhe t’i analizojmë fermerët, për shembull. Marrim fushat e Lezhës, Zadrimës, Torovicës, të Shënkollit. Sa ferma kemi aty? A kemi sistem të bazuar te feramat? A e kemi modelin e ekonomisë prodhuese? Jo, nuk e kemi. Kur nuk ka ekonomi prodhuese, fshatari nuk ka para, nuk ka të ardhura të qëndrueshme dhe toka nuk i nxjerr as shpenzimet e saj. Pse nuk kemi ferma? Pse nuk kemi prodhim që ta zgjidhnin vërtet një pjesë të problemit të varfërisë? Sepse nuk kemi as kushtet minimale, nuk kemi as drejtimin e duhur dhe as politika largpamëse. Nuk kemi mbështetjen shtetërore, nuk kemi subvencionin për prodhimin, siç e ka Bashkimi Europian, madje nuk kemi as mundësitë e vaditjes. Vitin që lamë pas qindra e mijëra hektarë tokë në qarkun e Lezhës nuk kishin vaditje, mbajti thatësi dhe njerëzit ankoheshin se po përpiqeshin të nxirrnin paratë e investuara, pasi për fitim as që bëhej fjalë. Pse nuk i kemi subvencionet? Pse nuk e kemi vaditjen? Pse nuk i kemi kushtet, mundësitë që të mund të kemi fitim, të arrijmë të kemi ekonomi dhe financa të qëndrueshme dhe të mos vinim sot këtu e të flisnim për lëmoshë, për bishta e për arnime? Pa dyshim është modeli ekonomik i gabuar.

Është modeli i ekonomisë kombëtare i bazuar në koncesione, i bazuar në shtetin partiak. Shikoni se si sot në çdo qytet e fshat kanë para vetëm ata që janë të lidhur me pushtetin dhe me pushtetet! Po të tjerët, a duhet të jetojnë? Po të tjerët, a duhet të kenë mundësi e hapësira? Nëse nuk je i lidhur me partinë-

shtet në Shqipëri, nuk ke asnjë mundësi: ose duhet të jetosh në varfëri, ose duhet të largohesh nga Shqipëria. A i dini shifrat se sa janë larguar nga Shqipëria? Merrni e lexojeni Eurostatin! Shikoni se si Shqipëria renditet me vendet e luftës dhe vendet në kriza humanitare, ku vetëm në vitin 2021 janë larguar rreth 11 000 shqiptarë. Le të flasim pak për rrogëtarët në Shqipëri, për ata që kanë një punë. Ta dini se, kur shkojnë për të blerë, numërojnë kokrrat e domateve, bëjnë llogari nëse duhet të blejnë një lakër apo dy lakra; matin gramaturën e djathit.

Pra, jemi tek ushqimet; jemi tek ushqimet e shportës. Nuk po shkojmë më tej, nuk po shkojmë te mundësia për të bërë pushime, te mundësia për të mirëmbajtur shtëpitë, te mundësia për të shkolluar fëmijët, te mundësia për të jetuar mirë, por po flasim vetëm për mbijetesë. Le të kalojmë pak edhe tek ata që as punën nuk e kanë. Ata që janë pa punë, kanë kufizim edhe të ushqimit. A e kuptoni ku jemi?! Jemi te kufizimet e ushqimit. Njerëzit nuk kanë para të blejnë as bukën e gojës. Për të mos u larguar nga modeli ekonomik: sa vende pune janë hapur në Shqipëri këto vite? Sot kemi një ekonomi me borxhe dhe me kredi. Kështu jetojnë shqiptarët dhe jo vetëm që nuk janë hapur vende pune, por janë mbyllur. Pagat tashmë janë shumë të ulëta përballë çmimeve që vetëm rriten dhe nuk dihet se sa do të rriten akoma në vazhdim. Zonja Ministre, a dalin 300 mijë lekë rrogë në muaj? Provojeni, futuni në market ju, të qeverisë, për të blerë dhe jo për propagandë, por futuni e blini vetë me dorën tuaj dhe do ta shihni a dalin apo nuk dalin 300 mijë lekë rrogë në muaj për ata "fatlumë" që e kanë edhe atë rrogë. Se ju i quani fatlumë. A do ta zgjidhë këtë problem arnimi me këtë akt normativ? E, pra, nuk e zgjidh dot.

Si do ta zgjidhim krizën e çmimeve? Është rritur çmimi i karburantit me 700 lekë. Automatikisht rriten të gjitha çmimet e tjera: mielli, buka, transporti, gjithçka. Si do zgjidhet kjo? A do të justifikoheni: "Është luftë."? Si ka mundësi që sapo organizohen protesta, çmimet ulen pak? Atëherë, neve na shkon mendja se nuk është vetëm lufta, por është spekulimi me luftën. Spekulum i organizuar dhe i mirëkoordinuar me qeverinë, sepse nuk mund të ketë dhe nuk ka përgjigje tjetër. Prandaj, nëse duam t'i japim zgjidhje kësaj shtate, do të duhej të ndryshohet modeli ekonomik. Do të duhej të ndryshohej qasja ndaj ekonomisë dhe ndaj shtetit. Do të duhej të rishikoheshin dhe të anuloheshin kontratat që janë firmosur, koncesionet e gjithçka tjetër. Do të duhej të rimodelohej shteti. Të mos kishim më shtet partiak, shtet vetëm për partinë politike dhe militantët e partisë, shtet që funksionon vetëm për t'i dhënë rrogën militantit fitues, por të kishim shtet ku të zënë më shumë vend profesionistët, njerëzit e mirëshkolluar, njerëzit, të cilët e dinë se çfarë duhet bërë dhe si duhet qeverisur. Do të duhej një qeveri ekspertesh dhe profesionistësh dhe jo një qeveri e ekspertëve për të manipuluar, për të vjedhur e për të mashtruar.

Këto do të ishin reformat e vërteta dhe reformat e duhura. Këto do të ishin politikat që do të kishin efekt. Për sa kohë nuk bëhen këto, njerëzit do të vazhdojnë të vuajnë. Njerëzit do të vazhdojnë të llogarisin: a e blejnë dot bukën? A e blejnë dot vajin 3 mijë lekë? A e blejnë dot djathin 7 mijë lekë e me radhë? Përveç çmimeve të larta e pagave të ulëta, ata përballen edhe me arrogancën e talljen. Del Kryeministri i vendit dhe i thotë rinisë shqiptare: "Të keni turp që protestoni". Po Kryeministri e kjo qeveri a duhet të kenë turp që po i dhunojnë shqiptarët me varfëri? A duhet të kenë turp që po i çojnë njerëzit në nivelet e mbijetesës? A duhet të kenë turp që po i detyrojnë njerëzit, të rinjtë dhe të rejtat të braktisin Shqipërinë? E, pra, protestuesit nuk kanë pse të kenë turp. Ata kërkojnë të drejtat e tyre, kërkojnë të mos spekulohet dhe të mos zhvatet në emër të shqiptarëve.

Prandaj sugjeroj kthimin mbrapsht të aktit normativ, sepse nuk zgjidh asgjë. Është arnim dhe asgjë tjetër. Në vend të këtij akti, duhet ndryshuar modeli ekonomik i Shqipërisë, të mos jetë një ekonomi vetëm e pakicës, vetëm e oligarkëve, e krimit të organizuar dhe njerëzve rreth tyre. Të dashur qytetarë, A e patë çfarë ka ndodhur? A e patë se si disa politikanë dhe zyrtarë të lartë të administratës janë organizuar me njëri-tjetrin për t'i vjedhur këtij populli plot 430 milionë euro? Disa kanë shkuar në burg. Duhet të shkojnë edhe të tjerë. Por, a e patë nga kush qeverisemi? Si do të ketë zhvillim ekonomik në Shqipëri, kur miliona e miliona euro, në vend që të shkojnë për subvencion bujqësor, në vend që të shkojnë për rroga, për sistem shëndetësor, për përmirësimin e administratës, për pensione, për ndihmë më të lartë sociale, u shkojnë bosëve të inceneratorëve, u shkojnë atyre që i vjedhin këto para dhe i transportojnë nga Shqipëria?!

Prandaj, kjo qeveri nuk duhet ta vazhdojë punën as një sekondë. Është kapur në flagrancë. Kjo nuk është qeveria e shqiptarëve dhe për shqiptarët. Është qeveria e inceneratorëve dhe për inceneratorët. Është qeveria e koncesioneve dhe për koncesionet. Është qeveria e oligarkëve dhe për oligarkët. Është qeveri e krimit të organizuar dhe për krimin e organizuar. Faleminderit!